



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja / Ministry of Agriculture,
Forestry and Rural Development

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

Në mbështetje të nenit 33, paragrafi 5, dhe nenit 62, paragrafi 5, të Ligji Nr. 08/L- 137 për Pyjet (Gazeta Zyrtare, Nr. 9/3 Prill 2023), nenit 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, Shtojca I, pika 11 të Rregullores (QRK)-NR.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (16.08.2023), si dhe Nenit 38 paragrafi 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare Nr. 15, dt. 12.09.2011),

Nxjerrë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR) - NR.11/2023 PËR SHFRYTËZIMIN E
PRODUKTEVE PYJORE JO-DRUNORE**

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim administrativ përcakton mbledhjen, grumbullimin, shfrytëzimin e qëndrueshëm të Produkteve Pyjore jo Drunore – PPJD-ve, si frutave pyjore, bimëve mjekuese, kërpudhave, farërave dhe prodhimeve tjera, nëse nuk rrezikohet ripërtërija dhe nuk shkaktohen dëme pyjeve, të cilat i kontribuojnë mirëqenies dhe punësimit të komunitetit.

Neni 2
Fushëveprimi

Dispozitat e këtij udhëzimi administrativ janë të obligueshme për zbatim nga Agjencia Pyjore e Kosovës, njësitë e saj përkatëse si dhe personat fizik dhe juridik, me të cilën përcaktohen mënyra e shfrytëzimit të produkteve pyjore jo drunore në pyjet, tokat pyjore publike, pyjeve në parqet kombëtare dhe zonat e mbrojtura, duke përmbyshur funksionet socio-ekonomike të pyllit dhe kompensimi për shfrytëzimin e tyre.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë këto kuptime:

1.1. **Produkte pyjore jo-drunore (PPJD)** – nënkuptojnë prodhimet pyjore me prejardhje nga kafshët, bimët ose mineralet të tjera nga prodhimet drunore dhe përfshijnë kërpudhat, frutat pyjore, bimët mjekësore, mjaltin, humusin, turbën, torfën, zhavorrin, rërën, dheun, mishin e gjahut të egër dhe peshkun;

1.2. **Mbledhësi** - nënkupton çdo person fizik të autorizuar për mbledhjen ose nxjerrjen e PPJD-ve në pajtueshmëri me këtë udhëzim administrativ, sipas lejes individuale ose në emër të një operatori;

1.3. **Operatori** – nënkupton personin juridik të autorizuar për mbledhjen dhe grumbullimin e PPJD-ve përmes një ose më shumë mbledhësve sipas lejes së lëshuar në pajtueshmëri me këtë udhëzim administrativ;

1.4. **Metodologjia** - nënkupton metodën për mbledhjen e PPJD-ve të miratuar nga Ministria, në pajtueshmëri me nenin 14 të këtij Udhëzimi Administrativ;

1.5. **Agjencia** – nënkupton Agjencinë e Pyjeve të Kosovës.

2. Shprehjet e tjera të përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë kuptimin e njëjtë ashtu siç përcaktohet në Ligjin Nr.08/L-137 Për Pyjet.

Neni 4

Mbështetja për shfrytëzimin e qëndrueshëm të prodhimeve pyjore jo drunore

1. Ministria dhe Agjencia ofron mbështetje për shfrytëzimin e qëndrueshëm të PPJD-ve përmes:

1.1. Mbledhjes së informatave lidhur me PPJD-të;

1.2. Realizimit të fushatave informuese, për prodhimet të cilat kanë potencial të mirë për shfrytëzim të qëndrueshëm;

1.3. Lehtësimin për ofrimin e asistencës teknike dhe trajnimeve për operatorët dhe mbledhësit;

1.4. Zhvillimit e hulumtimeve, programeve, skemave financiare për të ndihmuar shfrytëzimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të PPJD-ve.

2. Në ofrimin e mbështetjes nga paragrafi 1 i këtij neni, Ministria dhe Agjencia i japin përparësi aktiviteteve në të cilat pritet të përfitojnë banorët lokal, gratë në zona rurale dhe shoqatat e pronarëve të pyjeve private.

Neni 5

Projekti i shfrytëzimit të prodhimeve pyjore jo drunore dhe funksionet sociale

1. Agjencia harton projektin e shfrytëzimit të prodhimeve pyjore jo drunore dhe funksioneve tjera të pyllit.

2. Projekti nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të hartohet në harmoni me Udhëzimin Administrativ përkatës për Planifikimin e Menaxhimit të Pyjeve.

Neni 6 **Përcaktimi i zonave të mbledhjes**

1. Agjencia përcakton zonat e mbledhjes në bazë të Planeve Menaxhuese shumëqëllimore të Pyjeve, Planeve të Menaxhimit të Pyjeve brenda parqeve kombëtare, Programeve, Projekteve për shfrytëzimin e PPJD-ve dhe dokumenteve tjera të planifikimit vjetor.
2. Për përcaktimin e zonave sipas paragrafit 1 të këtij neni, Agjencia në konsultim me banorët lokal identifikon sipërfaqet e pyjeve dhe tokave pyjore shtetërore të përshtatshme për menaxhim të qëndrueshëm të një apo disa llojeve të PPJD-ve.
3. Zonat e përcaktuara sipas paragrafi 1 dhe 2 të këtij Neni, konsiderohen zona të mbledhjes të PPJD-ve dhe janë në funksion të menaxhimit të qëndrueshëm bazuar në përmbushje të funksioneve socio-ekonomike të pyjeve.
4. Përcaktimi i zonave sipas paragrafit 1 të këtij neni brenda parqeve kombëtare dhe zonave të mbrojtura bëhet në harmoni me nenin 47 të Ligjit Nr. 08/L-137 për Pyjet.

Neni 7 **Përcaktimi dhe ndarja e kuotave dhe lejeve për mbledhjen e PPJD-ve**

1. Lejohet vjelja, grumbullimi dhe shfrytëzimi i produkteve pyjore jo drunore si: frutave pyjore, bimëve mjekuese, kërpudhave, farërave dhe prodhimeve tjera për qëllime jo komerciale deri në dy (2) kilogram.
2. Vjelja, grumbullimi dhe shfrytëzimi i produkteve pyjore jo drunore sipas paragrafit 1 të këtij neni lejohet vetëm nëse nuk rrezikohet ripërtëritja e tyre dhe nuk shkaktohen dëme në pyje.
3. Grumbullimi i gurëve, zhavorrit, rërës, humusit, dheut dhe kullotja mund të bëhet vetëm në vendet që nuk shkaktohen dëme pylli dhe tokës pyjore rrëshqitje apo erozion dhe ndotje e mjedisit.
4. Agjencia në përputhje me Planet e Menaxhimit dhe projektin e shfrytëzimit të PPJD-ve deri në fund të muajit mars të çdo viti, përcakton kuotat/sainë e tyre mbledhje nga zonat e përcaktuara të mbledhjes për vitin përkatës.
5. Përcaktimi i kuotave për shfrytëzim të PPJD-ve sipas paragrafit 4 të këtij neni, gjithashtu duhet të jetë në pajtueshmëri me planin menaxhues të aplikueshëm, planin vjetor të silvikulturës, projektet e posaçme përkatëse dhe kufizimet eventuale të aplikueshme në zonat e mbrojtura.
6. Përcaktimi i kuotave sipas paragrafit 3 të këtij neni, bëhet nga Agjencia bazuar në të dhënat e grumbulluar nga viti paraprak.
7. Kuotat e përcaktuara në përputhje me paragrafit 4 të këtij neni publikohen në ueb faqen e Agjencia me ftesë për personat fizik dhe operatorët ekonomik që të dorëzojë aplikacionet për leje për mbledhjen e PPJD-ve brenda një afati të përcaktuar.

8. Në rastet kur numri i aplikantëve për leje pritet të tejkalojë kuotat e përcaktuara sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, Agjencia specifikon në ftesë kriteret bazë për përzgjedhjen e aplikantëve sipas paragrafit 4 dhe 5 të këtij neni.

9. Gjatë përcaktimit të kriterëve dhe përzgjedhjes me ftesë sipas paragrafit 8 të këtij neni, në çdo rast Agjencia, përparësi do t'u jepet banorëve të zonave lokale sidomos grave në ato zona.

10. Në rastet kur për shkaqe të njohura Agjencia nuk arrijnë të përmbush dhënien e kotave të PPJD-ve për banorët e zonave lokale dhe operatorët, atëherë organizon thirrje publike për shitjen e tyre, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 17 të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 8

Përcaktimi i çmimeve

1. Agjencia për çdo vit mban të dhënat e statistikore të çmimit të shitjes sipas llojeve të PPJD-ve.
2. Agjencia bënë analizimin e të dhënave statistikore të çmimit të shitjeve të PPJD-ve në bazë vjetore, dhe përcakton çmimin mesatar të tregut për secilën kategori apo lloj të PPJD-ve që mbledhen.
3. Periudha e përcaktimit të çmimit fillon nga 31 marsi i viti aktual të mbledhjes dhe përfundon me 30 mars të vitit ardhshëm.
4. Agjencia sipas paragrafëve 1, 2 dhe 3 të këtij neni, nxjerr dhe rishikon në baza vjetore çmimet apo çmimorën për PPJD-ve.

Neni 9

Regjistrimi i mbledhësve dhe operatorëve

1. Agjencia mban regjistrin e mbledhësve dhe të operatorëve.
2. Lejet sipas këtij udhëzimi administrativ jepen për mbledhës dhe aplikues të regjistruar si operatorë në regjistrin sipas paragrafit 1 të këtij neni në përputhje me Planet Menaxhues shumëqëllimorë të Pyjeve.
3. Agjencia vendosë kërkesa për regjistrimin e operatorëve sipas këtij neni, duke përfshirë kërkesat për ndjekjen e trajnimeve të përcaktuara për identifikimin e PPJD-ve dhe praktikantët më të mira për mbledhjen e tyre.

Neni 10

Lëshimi i lejeve për mbledhje

1. Agjencia është përgjegjëse për lëshimin e lejeve për mbledhjen, shfrytëzimin komercial dhe çdo shfrytëzim tjetër në rastin e pyjeve dhe tokave pyjore shtetërore.
2. Lëshimi i lejeve për mbledhje të PPJD-ve nga pyjet dhe tokat pyjore private është përgjegjësi e pronarit në bazë të programit të menaxhimit të pyjeve.
3. Agjencia me pëlqimin e Ministrisë përgjegjëse për Mjedis miraton projektin për dhënien e lejeve për shfrytëzimin e PPJD-ve dhe funksionet sociale të pyllit, brenda territorit të Parqeve Kombëtare dhe Zonave të Mbrojtura të Natyrës.

4. Kërkesa për vazhdimin e lejes për mbledhjen dhe grumbullimin e PPJD-ve nga operatorët duhet bëhet tre (3) muaj para skadimit të lejes paraprake.
5. Kërkesa për vazhdimin e lejes për mbledhjen dhe grumbullimin e PPJD-ve nga individët bëhet për çdo fillim viti deri me 30 mars të vitit aktual.
6. Brenda 30 ditësh nga dorëzimi i kërkesës sipas këtij neni, Agjencia e lëshon ose e refuzon lejen me arsyetimin përkatës.

Neni 11

Përmbajtja dhe formati i lejeve për mbledhje

1. Leja e lëshuar sipas këtij udhëzimi administrativ përcakton të gjitha kushtet e aplikueshme në lidhje me:
 - 1.1. Kuotat dhe llojin e prodhimeve që mund të mblidhen;
 - 1.2. Zonat nga të cilat mund të mblidhen prodhimet;
 - 1.3. Metodatat e mbledhjes, nxjerrjes dhe trajtimit të qëndrueshëm të prodhimeve;
 - 1.4. Periudhën e mbledhjes, dhe
 - 1.5. Kullotjen e shoqërive të bletëve.

Neni 12

Tarifat e aplikueshme për mbledhësit e prodhimeve pyjore jo drunore dhe operatorët

1. Pagesa për marrjen e lejes për mbledhje dhe grumbullim bëhet si vijon:
 - 1.1. Pagesa për aplikim dhe marrje të lejes për individ bëhet në shumën prej 10 € për vit.
 - 1.2. Pagesa për aplikim për marrje të lejes për operatorë bëhet në shumën prej 20 € për vit.
 - 1.3. Pagesa për marrje të lejes nga operatorët bëhet në shumën prej 200 € për 5 vite.
 - 1.4. Pagesa për vazhdimin e lejes për operatorët bëhet në shumë prej 100 € për 5 vite.
2. Agjencia siguron që Lejet e lëshuara sipas këtij udhëzimi administrativ të jenë në format të përshtatshëm për t'u bartur në terren.
3. Çdo person i pajisur me Leje sipas këtij udhëzimi administrativ, obligohet të bart me vete këtë leje gjatë gjithë kohës kur kryhen aktivitetet e mbledhjes dhe grumbullimit të PPJD-ve.
4. Tarifat e aplikueshme për mbledhësit, përkatësisht operatorët, për pajisje me leje për PPJD përcaktohen dhe rishikohen nga Ministria.

Neni 13

Detyrimet e operatorëve dhe mbledhësve

1. Operatorët dhe mbledhësit janë të obliguar të ofrojnë informata në lidhje me sasinë e prodhimeve të mbledhura në formën e kërkuar nga Agjencia.
2. Operatori obligohet të vë në dispozicion Agjencisë listën e të gjithë mbledhësve të përfshirë në aktivitete të mbledhjes dhe përpunimit, si dhe çdo informatë tjetër që mund të kërkohej nga Agjencia.
3. Subjektet juridike apo operatorët janë përgjegjës për ofrimin e trajnimit adekuat për mbledhësit e përfshirë në aktivitete të mbledhjes dhe përpunimit të PPJD-ve.
4. Në rastet kur lëshohen më shumë se një leje për të njëjtën zonë, çdo bartës i lejeve në atë zonë duhet të njoftohet për mbledhësit tjerë.
5. Mbledhësit obligohen të informojnë Agjencinë për aktivitete të paligjshëm në atë zonë.
6. Për aktivitete sipas paragrafit 2 dhe 3 të nenit 17 të këtij udhëzimi administrativ, subjekti juridik është përgjegjës të mbaj listën e mbledhësve dhe të vë në dispozicion të Agjencisë.
7. Subjekti juridik është i obliguar që në procesin e mbledhjes të PPJD-ve të angazhoj banorët lokal brenda dhe përreth zonave të mbledhjes.
8. Subjektet juridike kanë të drejtë të marrin pjesë në thirrje të ankandit publik për blerje të kuotave sipas paragrafit 3, të nenit 17, nëse dëshmojnë se posedojnë certifikatë për trajnime të kryera për mbledhje dhe grumbullim e PPJD-ve.
9. Certifikata për subjektet juridike sipas paragrafit 8 të këtij neni duhet të jetë e lëshuar nga institucione apo organizata të akredituara për trajnime në fushën e mbledhjes të këtyre prodhimeve.

Neni 14

Metodologjitë e mbledhjes

1. Ministria me propozimin e Agjencisë miraton dhe rishqyrton herë pas here metodologji për mbledhjen e llojeve të caktuara të PPJD-ve, në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare që Ministria i konsideron të përshtatshme, duke përfshirë Fair Wild, EU Organic, FSC ose të tjera.
2. Gjatë kryerjes së aktiviteteve sipas lejeve të mbledhjes të lëshuara sipas këtij udhëzimi administrativ, mbledhësit dhe operatorët respektojnë metodologjitë e përcaktuara sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Në çdo rast, përveç nëse parashihet ndryshe në një metodologji të miratuar sipas paragrafit 1 të këtij neni:
 - 3.1. Metodatat e mbledhjes nuk duhet të dëmtojnë mjedisin e rritjes duke siguruar kushte optimale për rigjenerimin e çdo lloj bimor të mbledhur;

- 3.2. Mbledhja dhe kultivimi lejohen ekskluzivisht në zonat e identifikuar si jo të ndotura, me largësi të përshtatshme nga burimet e mundshme të ndotjes si rrugët, industrinë, zonat e banimit, deponitë e mbeturinave dhe zonat bujqësore;
 - 3.3. Llojet bimore mblidhen në kushte adekuate të motit, duke shmangur vesën, dheun e lagësht, shiun ose lagështinë jashtëzakonisht të lartë të ajrit;
 - 3.4. Nëse mblidhen gjethet, 70% e gjetheve të bimës lihen në vend;
 - 3.5. Nëse mblidhen lulet, 30% e luleve të secilës bimë dhe 20% e gjithë popullatës së luleve lihen në vend;
 - 3.6. Nëse mblidhen farat, 30% e tyre lihen në vend;
 - 3.7. Nëse mblidhen frutat, 20% e tyre lihen për rigjenerim.
4. Ministria, në bashkëpunim me ekspertët përgatit dhe përditëson udhëzuesin e PPJD - ve për mbledhje, bazuar në herbariumin e përgatitur nga institucionet shkencore edukative.

Neni 15 Llojet e ndaluara

1. Agjencia herë pas here i rekomandon Ministrisë rishikimin e Librit të Kuq të PPJD-ve..
2. Ndalohet mbledhja, grumbullimi, transporti dhe tregtimi i PPJD-ve në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në Librin e Kuq.
3. Ndalohet mbledhja e PPJD-ve në zonat strikt të mbrojtura të natyrës.

Neni 16 Transportimi i PPJD-ve

Çdo person që gjatë lëvizjes transporton PPJD në sasi më të madhe se 2 kg, duhet të dëshmojë lejen e mbledhjes dhe grumbullimit të këtyre prodhimeve.

Neni 17 Shfrytëzimi komercial i PPJD-ve

1. Shitja dhe blerja e PPJD-ve bëhet vetëm nga mbledhësit dhe operatorët që kanë leje të lëshuara sipas këtij udhëzimi administrativ.
2. Nuk lejohet shitja dhe blerja e llojeve të PPJD-ve që nuk janë të përcaktuara në kuotat zyrtare sipas nenit 7 të këtij udhëzimi administrativ.
3. Agjencia përmes thirrjes të ankandit publik bën shitjen e kuotave të PPJD nga zonat e mbledhjes, për subjekte juridike.
4. Forma, përmbajtja, kriteret dhe mënyra e organizimit të ankandit publik përcaktohen me Ligjin për Prokurim Publik dhe dispozitave të këtij udhëzimi administrativ.

5. Për blerjet sipas paragrafit 3 të këtij nenin, subjektet juridike i nënshtrohen procesit të pajisjes me kontratë për kryerje të aktiviteteve të mbledhjes të PPJD- ve.

6. Kontrata duhet të specifikoj zonën e mbledhjes, sasinë e kuotave dhe llojeve të PPJD-ve të shitura.

Neni 18 **Të dhënat që do të mbahen nga Agjencia**

1. Agjencia mban të dhëna për:

1.1. Lejet e lëshuara sipas këtij udhëzimi administrativ, mbledhësit dhe operatorët të cilëve u është lëshuar leja;

1.2. Sasitë e PPJD-ve të mbledhura;

1.3. Çmimet e mbledhjes përcaktohen dhe rishikohen për vitin planifikues nga APK-ja, bazuar në çmimet e tregut të vitit paraprak.

2. Agjencia mban dhe raporton të dhëna për lejet e lëshuara për mbledhësit dhe operatorët sipas strukturës të gjinisë me kërkesën e institucioneve përkatëse.

Neni 19 **Shtojcat**

Formati i lejeve për mbledhje nga personat fizik, formati i lejes për operatorin dhe mbledhësit e angazhuar nga operatorët janë të përcaktuara në Shtojcat 1, 2 dhe 3, të cilat janë pjesë përbërëse e këtij udhëzimi administrativ.

VI. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 20 **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi administrative, shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2008 për kultivimin, grumbullimin, qarkullimin dhe shfrytëzimin e prodhimeve pyjore jodrunore i datës 6 mars 2008.

Neni 21 **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas Publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural



Shtojca 1

Formati i leje për mbledhje nga personat fizik

Logoja e Ministrisë/Agjencisë

Emërtimi: Leje për Mbledhjen e Prodhimeve Pyjore Jo-Drunore

Leja Nr.

Emri/ Mbiemri _____

Datëlindja _____

Nr. letërnjoftimit _____

Zona/lokacioni i mbledhjes _____

Dt. Lëshimit __/__/_____

Dt. Skadimit __/__/_____

Nënshkrimi i zyrtarit përgjegjës

-VV-

Pjesa e pasme e lejes përmban; Llojet e bimëve/prodhimeve që mund të mblidhen

Shtojca 2

Formati i lejes për operatorin (subjekti juridik)

Logoja e Ministrisë/Agjencisë

Baza ligjore

.....

L E J E

Për Grumbullimin e Prodhimeve Pyjore jo- Drunore

Nr. XX/2023

Zona e mbledhjes;....., Nj. Menaxhuese.....

Emri i operatorit; “.....”

Nr. biznesit.....

Emri i pronarit.....

Data e lëshimit
skadimit.....

Prishtinë,

Selia.....

Adresa.....

Data e

Drejtori

/ Nënshkrimi/

VV

Shtojca 3

Formati i leje për mbledhësit e angazhuar nga operatorët (subjektet juridike)

Logoja e operatorit

Emërtimi: Leje për Mbledhjen e Prodhimeve Pyjore Jo-Drunore

Leja Nr.

Emri/ Mbiemri i punonjësit: _____

Datëlindja; ___/___/_____

Nr. letërnjoftimit; _____

Zona/lokacioni i mbledhjes; _____

Dt. Lëshimit; ___/___/_____

Dt. Skadimit; ___/___/_____

-VV-

Nënshkrimi i menaxherit

Pjesa e pasme e lejes përmban: Llojet e bimëve/prodhimeve që mund të mblidhen